Impressum

Berufs- und Weiterbildungsberatung BWB
Telefon 041 666 63 44
E-Mail berufsberatung@ow.ch
www.berufsberatung-ow.ch

Ausgabe 2017

Satz und Druck:
von Ah Druck AG, Sarnen

Arsimi në Zvicër

Informationsbroschüre für Eltern Albanisch

Kanton Obwalden

Bildungs- und Kulturdepartement BKD
Amt für Berufsbildung AfB
Berufs- und Weiterbildungsberatung BWB

Bildungswege



Arsimi në Zvicër

Arsimi profesional si edhe gjimnazi iu ofrojnë të rinjëve perspektiva tërheqëse. Për suksesin në profesion është i rëndësishëm jo vetëm drejtimi i arsimimit, por para së gjithash kënaqësia në të mësuar dhe angazhimi që rrjedh prej saj.

Vendimtare për zgjedhjen e rrugës së shkollimit janë interesat dhe aftësitë vetjake si edhe mundësitë personale për të patur rezultate. Është e rëndësishme, që zgjedhja e shkollimit të mos jetë e orientuar thjesht sipas prestigjit të një profesioni ose sipas tregut të punës.

Në Zvicër zgjedhin 20% e gjithë të rinjëve gjimnazin dhe marrin maturën. 70% vendosin për një nga mbi 200 drejtimet për mësimin e një profesioni me përfundim të njohur nga shteti (EBA ose EFZ).

Ofertat-urë (Brückenangebot) janë të hapura për të rinjtë, që nuk e kanë gjetur akoma hyrjen në mësimin e profesionit, megjithë përpjekjet që kanë bërë për zgjedhjen e profesionit dhe për gjetjen e një vendi mësimi.

Sistemi arsimor është shumë i përshkueshëm. Dikush, që për shembull ka filluar me një mësim profesioni, mundet më vonë pas maturës profesionale të studiojë në një shkollë të lartë profesionale ose pasi ka marrë provimin plotësues të studiojë në një universitet.

Për çdo shkollim dhe në çdo fushë profesionale ofrohen specializime të mëtejshme. Këtu vlen motoja: nuk ka përfundim pa vazhdim. Shkollat me përfundim të njohur nga shteti hapin rrugën për specializimet e mëtejshme dhe ndryshimet në profesion.

Në shumë degë janë të kërkuar specialistë të orientuar nga praktika dhe që kanë bërë një provim për profesionin (Berufsprüfung/BP), një provim më të lartë profilizimi (Höhere Fachprüfung/HFP) ose një shkollë më të lartë të profilizuar (Höhere Fachschule/HF). Këto nuk vënë si kusht maturën profesionale.

Ndërmjet degëve profesionale ka diferenca të mëdha në rrogë. Kohëzgjatja e shko-llimit ndikon shpesh në madhësinë e rrogës.

Personat që nuk kanë mësuar një profesion (zanat) ose nuk kanë përfunduar studimet mbartin një rrezik më të madh, për të qenë për kohë të gjatë pa punë. Shkollimi mund të të mbrojë nga papunësia.